



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



UDHËZUES PRAKTIK PËR LEHTËSIMIN E USHTRIMIT TË DREJTËS PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

(Ky udhëzues shpjegon mënyrën se si zbatohet Ligji për Qasje në Dokumentet Publike, si të hartohet një kërkesë për qasje në dokumente publike dhe çfarë hapash mund të ndërmerren nëse kërkesa për qasje kufizohet apo refuzohet)

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE?

- Synimi i ligjit është që t'i bëjë institucionet publike më të hapura dhe më të përgjegjshme ndaj qytetarëve;
- I ndihmon njerëzit të kuptojnë më mirë se si autoritetet publike kryejnë detyrat e tyre, pse ata marrin vendime të caktuara dhe se si ata e shpenzojnë paratë publike si dhe
- Promovon kulturë të transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha institucionet publike, gjë që shpjen deri tek marrja e vendimeve më të mira.

LIGJI PËR QASJE NË DOKUMENTET PUBLIKE

Ligji për Qasje në Dokumente Publike ju jep juve të drejtën që të kërkonti nga cilido institucion publik të gjitha dokumentet që ai institucion i posedon ai institucion për temën që juve ju intereson.

- Përveç nëse organi përkatës ka një arsye të bazuar në ligj, ai duhet të ju siguroj juve informatat e kërkuara brenda 7 afatit ditor.
- Në rrethana kur në bazë të një vlerësimi të arsyeshëm shihet të jetë e nevojshme për mbrojtjen e jetës apo lirisë së një personi, institucioni publik duhet të e jep përgjigjen brenda 48 orëve.

Çdokush mund të paraqesë kërkesë për qasje – nuk ka asnjë kufizim mbi moshën, gjininë, etninë, gjuhën, përkatësinë fetare, vendbanimin, vendqëndrimin apo diçka tjetër.

Ju mund të kërkonti çfarëdo dokumente publike – mirëpo për disa informata mund të mos iu jepet qasja për shkak të mbrojtjes së interesave të ndryshme sikurse që janë të përcaktuara në ligj. Në raste të këtilla, institucioni publik duhet t'iu informoj për arsyen për të cilin nuk do t'iu sigurojë informatat e kërkuara.

KUSH MBULOHEK NGA LIGJI?

Ligji aplikohet ndaj të gjitha institucioneve publike, duke përfshirë:

- Ministrinë dhe agjencitë e tyre;
- Komunat;
- Gjykatat;
- Prokuroritë;
- Shkollat, Kolegjet dhe Universitetet;
- Kompanitë publike në të cilat shteti zotëron shumicën e aksioneve apo të cilat ushtrojnë një funksion publik.

Institucionet e pavarura sikurse:

- Zyra e Avokatit të Popullit;
- Zyra e Kombëtare e Auditimit;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;

- Banka Qendrore e Kosovës;
 - Komisioni i Pavarur i Mediave;
- Institucionet e pavarura të themeluara sipas Kapitullit XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

NË CILAT DOKUMENTE NUK MË LEJOHET TË KEM QASJE TË PLOTË ?

Dokumentet në të cilat qasja nuk është e lejuar janë kryesisht ato që kanë për qëllime të mbrojtjes së:

- jetës, shëndetit dhe të sigurisë publike;
- sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare;
- parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit;
- hetimet disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;
- inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar;
- të drejtës për privatësi dhe e drejta e fshirjes (‘E drejta për t’u harruar’); konfidencialitetit komercial siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë;
- dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;
- politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
- konfidencialitet statistikor;
- barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
- diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën dokument të klasifikuar.

Nëse kërkesa e juaj hyn në kuadër të këtyre kategorive, institucioni duhet të ju informojë për këtë.

SI TË PARAQESË NJË KËRKESË?

Për ta paraqitur një kërkesë qasje në dokument publik, ju i keni disa mundësi në dispozicion. Kërkesën mund ta dërgoni me shkrim qoftë në institucion drejtëpërdrejtë, qoftë përmes postës, përmes postës elektronike (e-mail) ose edhe verbalisht në institucionin publik, ndërsa në kërkesën e tillë, pavarësisht formës që e dërgoni, ju duhet të shënoni në kërkesë këto të dhëna:

- emrin dhe mbiemrin tuaj;
- një adresë ku mund të ju kontaktojnë si dhe
- një përshkrim të dokumentit të cilin e kërkon

Për t'i ndihmuar organit publik që ta gjejë dokumentin në fjalë, ju duhet të siguroni sa më shumë detale që të jetë e mundur. Për shembull, mund të kërkonti “vendimin X” që është mbajtur në mbledhje dhe jo “të gjitha dokumentet që i keni lidhur me çështjen X”.

Të gjitha institucionet publike duhet të mbajnë në uebfaqen zyrtare informata lidhur me mënyren, formën e paraqitjes së kërkesës për qasje në dokumente publike.

KUSHMUND TË KËRKOJË INFORMACION OSE QASJENË DOKUMENTE PUBLIKE ?

Këtë të drejtë e ka çdo individ që është në gjendje të bëjë një kërkesë për informacion tek një institucion publik përkatës. Një parashtrues i kërkesës ka të drejtë që të pranojë informatat dhe dokumentet e kërkuara, përpos nëse përjashtimet për qasje në ato informata apo dokumente publike zbatohen sipas ligjit. Nëse ndonjë informacion ose dokument publik u është kufizuar ose refuzuar, institucioni duhet t'ju japë arsyet për kufizimin ose refuzimin e tillë dhe njëkohësisht të ju sqarojë drejtë procesin e ankimit.

ÇFARË DUHET TË BËJË PARA SE TË BËJË NJË KËRRESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE?

Ju mund të kërkonti çfarëdo informate ose dokument publik që ju dëshironi, në çdo kohë, por nuk do të thotë që ju gjithmonë të keni sukses në marrjen e informatës ose dokumentit publik të kërkuar. Para se të bëni një kërkesë, mund të jetë e dobishme nëse i keni parasysh këto rrethana:

- ***A është informata që ju dëshironi në dispozicion, për shembull, në faqen zyrtare të institucionit ?***

Institucionet publike duhet që në baza rutinore të vejnë informata dhe dokumente të caktuara në dispozicion. Ju mund të gjeni se çfarë informata janë në dispozicion duke kontrolluar ueb-faqen e tyre ose duke e kontaktuar institucionin.

- ***A është informata që ju kërkonti e lidhur me të dhënat tuaja personale?***

Nëse kërkesa juaj është për informacion në lidhje me veten tuaj, si për shembull të dhënat e juaja mjekësore, ju duhet të parashtroni kërkesën në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- ***A ka gjasa që institucioni të posedojë informacionin që ju e kërkonti?***

Kjo mund të ju kursejë kohë në qoftë se ju e verifikoni tek institucioni nëse ata e posedojnë informatën ose dokumentin që ju e kërkonti. Institucionet publike duhet të japin ndihmë dhe këshilla të arsyeshme për këdo që kërkon informacion, andaj, ju duhet të ndjeheni të lirë për të kërkuar ndihmë për parashtrimin e kërkesës tuaj.

- ***A është informacioni që ju e kërkonti i përshtatshëm për publikim të përgjithshëm?***

Qëllimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është që të vejë informatat në dispozicion për

publikun e gjerë. Ju do të mund të merrni vetëm informatat që do t'i jepeshin kujdo që i ka kërkuar, apo të cilat do të ishin të përshtatshme për publikun e gjerë për t'i parë.

Disa informacione, si për shembull të dhënat lidhur me një të afërm të ndjerë, apo dokumentet që ju duhen për qëllime ligjore, mund edhe të mos jenë gjithmonë në dispozicion në bazë të ligjit. Megjithatë, e drejta për të parë informacionin që ju dëshironi mund t'ju sigurohet edhe në bazë të një ligji tjetër. Institucioni publik i cili është në posedim të informatës të cilën ju e kërkon, duhet që t'ju këshillojë në këto raste.

SI DUHET TA PARASHTRONJ KËRKESËN TIME ?

Kërkesa juaj duhet të përcaktojë qartë dokumentin që ju e dëshironi. Me rastin e parshtrimit të kërkesës:

- Bëhuni sa më i qartë që të jetë e mundur. Nëse institucioni publik nuk është i sigurt se çka po kërkon, ai do t'ju pyes për më shumë sqarime.
- Mundohuni të identifikoni saktë dokumentin të cilin ju po e kërkon. Ta keni parasysh që institucioni ka të drejtë të ju ngarkojë me një tarifë për dokumentin e kërkuar, për të mbuluar shpenzime të tilla sikurse që është fotokopjimi i dokumentit përkatës.
- Përdorni gjuhë të drejtpërdrejtë dhe të sjellshme, kujdes që të mos e mbështetni kërkesën ose pyetjen tuaj në supozime ose opinione apo që kërkesën ta përzieni me një ankesë ose me komente.
- Deklarohu se si preferoni ta merrni informatën, për shembull, në formë elektronike ose si një kopje të printuar, nëse një gjë e tillë është e mundur.

ÇFARË MUND TË KËRKOJ?

Ju mund të pyesni për ndonjë informacion ose kërkon ndonjë dokument publik që ju mendoni se një autoriteti publik mund ta ketë. E drejta për qasje përfshinë vetëm informatën e regjistruar, që nënkupton informatat e mbajtura në kompjuter, në email apo të shtypura, ose dokumente të shkruara me dorë, si dhe imazhe, video dhe audio incizime.

- Ju duhet të identifikoni informatën ose dokumentin publik që ju e kërkon sa më qartë që të jetë e mundur.
- Disa informata ose dokumente publike ndoshta nuk mund të ju jepen për shkak se ato mund të jenë të përjashtuara, si për shembull në rastet kur në mënyrë të padrejtë të zbuloheshin detaje personale në lidhje me dikë tjetër.

SA KOHË ZGJATË MARRJA E PËRGJIGJES PAS PARASHTRIMIT TË KËRKESËS PËR QASJE?

Pas parashtrimit të kërkesës tuaj për qasje, përgjigjen do ta merrni brenda 7 ditëve nga institucioni ku e keni dërguar kërkesën e tillë. Ky afat mund të zgjatet deri në 15 ditë në rrethana të caktuara, me

ç'rast institucioni duhet të ju njoftojë me shkrim mbi arsyen e zgjatjes së afatit dhe për afatin e ri kur do ta merrni përgjigjen.

SA KUSHTON?

Trajtimi i kërkesave bëhet pa pagesë. Megjithatë, nga ju mund të kërkohet që të paguani një shumë të vogël për mbulimin e shpenzimeve të fotokopjimit ose atyre postare. Kjo pagesë do të jetë e arsyeshme dhe nuk do të jetë më e madhe se kosto reale për prodhimin e fotokopjeve.

A MUNDËM TË ZGJEDH SE SI UNË E PRANOJ INFORMACIONIN OSE DOKUMENTIN PUBLIK TË KËRKUAR?

Po. Kur e parashtroi kërkesën, ju mund të cekni preferencën tuaj se si doni që informacioni ose dokumenti publik i kërkuar të komunikohet/dërgohet tek ju. Kjo mund të jetë në formë të fotokopjes, të kopjes elektronike të informacionit, ose të u jepet mundësia që ta shikoni dokumentin në zyrat e institucionit.

SI MUND T'I MARRË INFORMATAT/DOKUMENTET PUBLIKE?

Në kërkesën për qasje në dokumente publike ju mund të kërkoni që informatat e kërkuara të ju sigurohen në një mënyrë të caktuar. Për shembull, ju mund të kërkoni kopje të shtypura ose elektronike të dokumenteve origjinale ose mund të kërkoni që t'i shikoni disa dokumente të caktuara.

ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE INSTITUCIONI PUBLIK NUK PËRGJIGJET NË KËRKESËN TIME ?

Heshtja ose mospërgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar me ligj, konsiderohet si përgjigje negative. Pas kësaj, ju mund të ankoheni tek Agjencia për Informim dhe Privatësi ose në Institucionin e Avokatit të Popullit.

ÇFARË MUND TË BËJË NËSE KËRKESA IME REFUZOHET?

Nëse kërkesa e juaj për qasje në dokumente publike refuzohet plotësisht ose pjesërisht dhe nëse ju nuk pajtoheni me vendimin e tillë, atëherë, ju mund të ankoheni tek:

- Agjencia për Informim dhe Privatësi, i cili është organi kompetente për mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të këtij Ligji dhe
- Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili i ndihmon qytetarët në realizimin e të drejtës për qasje në dokumentet publike.

LINQET E AGJENCISË PËR PRIVATËSI DHE INFORMIM DHE INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Për informacionet që mund të ju shërbejnë nga këto institucione, më poshtë i keni të paraqitura linqet e uebfaqeve të tyre në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze:

1. Agjencia për Informim dhe Privatësi

- Linku në gjuhën shqipe: <https://aip.rks-gov.net/>
- Linku në gjuhën serbe: <https://aip.rks-gov.net/sr/>
- Linku në gjuhën angleze: <https://aip.rks-gov.net/en/>

2. Institucioni i Avokatit të Popullit

- Linku në gjuhën shqipe: <https://www.oik-rks.org/>
- Linku në gjuhën serbe: <https://www.oik-rks.org/sr/>
- Linku në gjuhën angleze: <https://www.oik-rks.org/en/>

Shërbimet në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe Institucionin e Avokatit të Popullit janë pa pagesë.